



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

BE LAJME korrik/2016
BEQ-numër23/2016



PRIORITETET E KRYESIMIT SLOVAK ME KËSHILLIN E BASHKIMIT EVROPIAN



Slovakia më 1 korrik 2016 e mori kryesimin me Këshillin e Bashkimit Evropian nga Holanda. Slovakia në gjashtë muajt e ardhshëm do të kryesojë me BE-në si pjesë e treshes 18 mujore presidenciale në të cilën bëjnë pjesë Holanda dhe Malta.

Kryesimi slovak me Këshillin e BE-së filloi në një kohë kur unioni po ballafaqohet me sfida të papara:

- rezultati i referendumit në Britaninë e Madhe, imponon një debat për të ardhmen e Unionit.
- vazhdimi i krizës së migrimit ngritë çështje që kanë të bëjnë me integritetin e zonës së Shengenit.
- sulmet terroriste në Paris dhe Bruksel i vënë në pah dobësitë nga sfera e sigurisë së brendshme dhe
- pasojat e krizës ekonomike dhe financiare ende ndikojnë në ekonominë e vendeve-anëtare të BE-së.

Vizioni i kryesimit slovak bazohet në dy shtylla:

• *Agjenda pozitive*

Do të përkushtohet një përpjekje maksimale në projekte të ndërtuara në bazë të përvojës së mirë të arritur në kuadër të tregut të brendshëm, që do të zgjerohet edhe në shtylla të reja. Heqja e barrierave në mes vendeve-anëtare çon drejt një dobie të vërtetë për ekonominë dhe qytetarët.

Zgjidhjet e qëndrueshme

Kryesimi slovak dëshiron që të promovojë zgjidhje të reja që në rast të një reagimi urgjent, do të merreshin parasysh edhe perspektivat afatgjate. Kjo qasje është me rëndësi esenciale për BE-në.

Programi i kryesimit slovak bazohet në **katër prioritete**: Evropë të fuqishme ekonomikisht, një treg unik të moderuar, politika të qëndrueshme për migrim dhe azil si dhe angazhim të Evropës në nivel

global.

1. Evropë e fuqishme ekonomikisht: Ambienti i volitshëm është parakushti kyç për zhvillimin dhe implementimin e projekteve bashkuese të Evropës, që janë elemente fundamentale të tregut unik modern.

2. Treg unik modern: Vizioni i kryesimit Sloven është edhe më tutje në zhvillimin e projekteve bashkuese, siç janë unioni energjetik ose tregu unik digjital.

3. Politikat e qëndrueshme për migrim dhe azil: Kryesimi slovak do të tentojë që ta inkurajojë Unionin për të zhvilluar më shumë politika të qëndrueshme për migrim dhe azil.

4. Evropë e angazhuar globalisht: Me rëndësi është që të promovohet stabilitet, prosperitet dhe demokraci ndaj fqinjëve të BE-së. Kryesimi slovak ka për qëllim që ta forcojë pozitën e Unionit në botë.

Tema prioritare të Kryesimit sloven janë të udhëhequra nga tre parimet e lidhura mes vete:

1. Arritja e rezultateve të dukshme – qëllimi është që t'u tregohet qytetarëve të BE-së se projektet e përbashkëta evropiane kanë ndikim praktik në përmirësimin e kualitetit të jetës së tyre.

2. Tejkalmi i fragmentimit – qëllimi është që të arrihen rezultate që do të ndihmonin të lidhen vendet anëtare më afër në kuadër të tregut të unifikuar;

3. Fokusi ndaj qytetarëve – me qëllim që të jepen rezultate konkrete dhe të tejkalohej fragmentimi për sjelljen e Unionit më afër qytetarëve .

<http://www.eu2016.sk/en/programme>

Përmbajtja e lajmeve:

Prioritetet e kryesimit Slovak me Këshillin e BE-së	1
Në fokusin e Parlamentit Evropian	2
Thellimi i bashkëpunimit në mes të BE-së dhe NATO-s	3
Instrumentet e reja financiare për nxitjen e investimeve	4
Direktiva për siguri të rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve informative	5
Prezantimi i programit dhe prioriteteve të kryesimit Slovak me Këshillin e BE-së	6
Sfidat për vendosjen e marrëdhënieve të reja ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së	6
Propozim-buxheti i BE-së për vitin	7
Vjena, kryeqendra evropiane e akullores	8
Ligji i ri për shitjen e prodhimeve vendase në Rumani	8
Hetimi i iniciuar për damping çmimet e çelikut	9
BE kalendari/shtator/2016	9

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

Seanca plenare 4-7 korrik 2016

Me qëllim që të jenë në hap me përparimin teknologjik, eurodeputetët më 6 korrik të këtij vitin bënë ftesë për krijimin e një shkalle të re dhe më të rreptë prej në A deri në G, për efikasitetin energjetik të pajisjeve të amvisërisë. Shumica e aparateve në treg, momentalisht i plotësojnë kërkesat e "shkallës A", me kushtet e vendosura nga viti 2010. Me qëllim që shkallët prej në A deri në G të jenë homogjen, nevojitet që të futet një shenjë me vlerë të ndryshueshme për prodhimet ekzistuese. Në rezolutën e miratuar eurodeputetët ftuan që çdo ndryshim në të ardhmen duhet të jetë me qëllim që të njëjta të vlerjë në dhjetë vitet e ardhshme, dhe duhet të aktivizohet kur 25% e prodhimeve që janë në tregun e Unionit do të rangohen me shkallë më të lartë të efikasitetit energjetik, respektivisht me shkallën A.

Parlamenti evropian e miratoi raportin për formimin e rojës bregdetare kufitare evropiane, e cila do ta lidhte Fronteksin me trupat e vendeve anëtare, përgjegjëse për menaxhimin me kufijtë.

Plani për azhurnimin e rregullave të BE-së për miratimin e llojit dhe kufizimit të emisioneve për motorët me djegie të brendshme të makinat lëvizëse (kosat, buldozerët dhe lokomotivat me naftë) mori përkrahjen e Parlamentit Evropian. Për planin veç më ishte arritur pëlqim edhe nga kryesia holandeze me Këshillin e BE-së.

Liderët e BE-së duhet të përgjigjen ndaj brengave të qytetarëve për referendumin dhe lëshimin e Britanisë së Madhe të BE-së në mënyrë që do të mbrohej projekti i BE-së. Kjo ishte porosia kryesore nga debati i Parlamentit Evropian, me kryetarin e Këshillit Evropian, Donald Tusk dhe kryetarin e komisionit Evropian, Zhan-Klod Juncker.

Kryeministri Holandez Mark Rute mori lëvdata nga shumica e grupeve politike në PE, për efikasitetin e Holandës me kryesimin e BE-së në gjysmën e parë të vitit. Si aktivitete më të rëndësishme që janë realizuar, u përmendën: marrëveshja e arritur në mes të BE-së dhe Turqisë për migrimin, marrëveshja e agjencisë për roje bregdetare kufitare evropiane, masat për luftën kundër shmagies së pagesës së tatimit dhe pakoja e katër për komunikacionin hekurudhor.

Sulmet kibernetike mund të shkaktojnë dëm të konsiderueshëm të infrastrukturës evropiane për shërbime siç është furnizimi me energji elektronike, shërbimet bankare dhe shëndetësore, transporti, kontrolli i fluturimit. Me propozim të Komisionit Evropian, eurodeputetët miratuan masat për futjen e nj shkalle të lartë të sigurisë në sistemet e rrjeteve dhe ato informatike të Unionit. Kompanitë patjetër do të duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre në ballafaqimin me sulmet kibernetike. Rregullat e reja mundësojnë një grup strategjik për bashkëpunim, shkëmbim të informatave dhe ndihmë për vendet anëtare gjatë ndërtimit të sigurisë kibernetike. Secili vend-anëtar do të duhet patjetër ta transponojë Direktivën për siguri të

rrjetit dhe atë informatike, si dhe ta zhvillojë rrjetin CSIRT (Computer Security Incident Response Teams), për përpunimin e incidenteve dhe rreziqeve, sigurisë tejkuftare dhe identifikimin e përgjigjeve të koordinuara. Eurodeputetët debatuan me përfaqësuesit e Komisionit dhe të Këshillit, për gjetjen e mënyrës më të mirë për mbrojtjen e të a.sh fishkëlljes. Shumica e eurodeputetëve deklarojnë se nevojitet një harmonizim shtesë i legjislacionit të BE-së për mbrojtjen e fishkëlljesve dhe të forcohen me ligje nacionale.

Në seancën plenare Parlamenti Evropian miratoi rekomandime për tatimin të drejtë dhe të qarta në aspekt korporativ. Eurodeputetët ftuan në krijimin e regjistrat të BE-së për pronarët e kompanive, si dhe listën e zezë të bazave të tatimit, sanksione kundër juridiksioneve jokoperative tatimore, kodit të sjelljes së bankave dhe këshilltarëve tatimor, rregullave të mira tatimore për menaxhim me përgjigjet për tregti të BE-së, bazë të përbashkët dhe të konsoliduar tatimore dhe të tatimit të ruajtur të fitimit në BE.

Parlamenti evropian dha rekomandimet e veta në aspekt të Propozim-programit për punë të Komisionit Evropian për vitin 2017. Para votimit, eurodeputetët debatuan edhe për prioritetet e BE-së me nënkryetarin e parë të komisionit, Frans Timmermans dhe njëherë përgjegjës për rregullativë më të mirë, lidhje ndërinstitucionale, sundimin e të drejtës dhe të drejtat fundamentale. Motivi për këtë debat ishte nevoja për mendime lidhur me drejtimin që duhet ta ndërmarrë BE-ja pas referendumit të Britanisë së Madhe për anëtarësim në BE. Në maje të agjendës së BE-së në vitin 2017 duhet të jenë vendet e punës, të drejtat sociale dhe siguria. Pritet që Komisioni ta prezantojë programin e punës për vitin 2017, në seancë të PE më 25 tetor të këtij viti.

Në debatin me eurodeputetët lidhur me prioritetet e kryesimit Sllovak me BE-në, kryeministri i Sllovakisë Robert Fiko theksoi se "Bashkimi Evropian patjetër duhet të unifkohet dhe të japë rezultate reale, me përfitime të qarta për qytetarët e saj, ta kthejë besimin dhe të luftojë kundër popullzimit dhe nacionalizmit në rritje përgjatë kontinentit".

Tregtia me njerëz është një krim ndërkombëtar dhe me profite të larta ku njerëzit keqpërdoren në forma të ndryshme të eksploatimit. Në seancën plenare eurodeputetët miratuan rezolutë dhe e dënuan këtë lloj të robërisë si një prej formave më të këqija të shkeljes së të drejtave të njeriut .

<http://www.europarl.europa.eu/portal/en>

THELLIMI I BASHKËPUNIMIT NË MES TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE NATO-S

Në samitin e NATO-s që u mbajt më 8 dhe 9 korrik të këtij viti në Varshavë, kryetari i Komisionit Evropian Zhan Klod Juncker nënshkroi një deklaratë të përbashkët për bashkëpunim në mes të BE-së dhe NATO-s me sekretarin gjeneral të NATO-s Jan Stoltenberg dhe kryetarin e Këshillit Evropian, Donald Tusk. Kryetari gjithashtu ftoi për një unitet transatlantik së bashku me presidentin e SHBA, Barak Obama.

“Deklarata që e nënshkruam sot dërgon një porosi të qartë: një Bashkim Evropian më të fortë që nënkupton edhe një NATO më të fortë dhe që ajo prapë nënkupton një Bashkim Evropian më të fortë” tha kryetari Juncker pas nënshkrimit të marrëveshjes së re. “Aktivitetet tona dhe resurset tona plotësohen njëra me tjetrën. Por, sot vendosëm që të bëjmë diçka më shumë. Duhet patjetër ti shfrytëzojmë të gjitha mjetet që i kemi në dispozicion.”

Kryetari theksoi një numër të madh të fushave në të cilat BE-ja ka siguruar përkrahje politike, materiale dhe financiare, përfshirë edhe përgjigjen e kërcënimeve hibride, investimeve në sektorin për sajber siguri në Evropë dhe bashkëpunim detar si përgjigje ndaj krizës së refugjatëve. Ai e theksoi edhe përkushtimin e BE-së ndaj së ardhmes së industrisë së saj mbrojtëse. Theksoi se deri në fund të vitit do të prezantohet një Plan Aksionar për mbrojtje që do ti bashkojë të gjitha mjetet që mund ti ofrojë Bashkimi Evropian - politikat, programet e financimit të BE - për përkrahje të bashkëpunimit në mbrojtje dhe industrinë e mbrojtjes.

Kryetari i Komisionit Evropian, Juncker së bashku me kryetarin e Këshillit Evropian, Tusk, u takua me kryetarin e SHBA, Barak Obama. Të gjithë e konfirmuan rolin e BE-së, SHBA-ve dhe NATOS, si shtyllat

qendrore të rendit global. “Detyra jonë e parë është të dëshmojmë një unitet dhe përsëri të afirmohen vlerat që i ndajmë: të drejtat e njeriut, liritë, demokracia dhe sundimi i së drejtës”, theksoi kryetari Juncker.

Para mbajtjes së samitit Juncker, Tusk dhe përfaqësuesi i lartë i BE-së Mogerini, u takuan me delegacionin amerikanë të prirë nga kryetari Obama. Takimi ishte mundësi që të theksohet uniteti transatlantik dhe të diskutohet për sfidat e përbashkëta politike, ekonomike dhe të sigurisë ndërkombëtare. Në takim për herë të parë kishin mundësi që së bashku të bisedohet edhe për rezultatin e referendumit të Britanisë së Madhe.

Deklarata e përbashkët e nënshkruar e BE-së dhe NATO-s është e para e këtij lloji. Deklarata e përbashkët që pason pas diskutimit për bashkëpunim në mes të BE-së dhe NATO-s në Këshillin e fundit Evropian më 28 qershor 2016, e që është në pajtim me ftesën e shefave të shteteve ose qeverive të BE-së, do ta shënojë rëndësinë për forcimin e mëtejshëm të BE-së dhe NATO-s gjatë sfidave të sigurisë nga Lindja dhe Jugu.

Në kuadër të Samitit, u realizuan një numër i madh i takimeve bilaterale .

http://ec.europa.eu/news/2016/07/20160707_en.htm



INSTRUMENTET E REJA FINANCIARE PËR NXITJEN E INVESTIMEVE



Për tu lehtësuar qasja deri te financat e kompanive të reja dhe promovuesit e projekteve për zhvillim urban, Komisioni Evropian më 11 korrik të këtij viti miratoi dy instrumente të reja dhe lehtë të kapshme që menjëherë mund të shfrytëzohen për investime nga fondet evropiane strukturore dhe investive.

Komisioni i nxitë vendet anëtare, në periudhën 2014-2020, dyfish të rrisin investimet e fondeve evropiane strukturore dhe ato investuese, që shfrytëzohen si instrumente financiare si kredi, investime kapitale dhe garanci në pajtim me qëllimet e planeve investive.

Komisari Evropian, përgjegjës për politikën rajonale Korina Kretu, theksoi se instrumentet financiare janë mënyrë efektive për investim në ide të reja, ndërmarrje dhe në talentin e qytetarëve të BE-së, e njëkohësisht shfrytëzohen më pak mjete publike. Këto instrumente kanë potencial të madh për mobilizimin e kapitalit privat.

Instrumentet financiare, lehtë të arritshme, janë në pajtim me Rregullativën e ESI për fondet dhe rregullat për ndihmë shtetërore. Janë të dizajnuara me qëllim që të rritet pranueshmëria e burimeve të ripërtërishme të përkrahjes financiare, në vend të grandeve tradicionale të vendeve-anëtare si dhe kombinimin e fondeve publike dhe private.

Veç më ka instrumente të këtij lloji: hua në bazë të ndarjes së rrezikut, që bazohet në ndarje të rrezikut në mes të fondeve private dhe publike, dhe instrument për garanci, në të cilin paratë publike shfrytëzohen si garanci në rast të mosplotësimit të portfolios kredituese. Qëllimi i këtyre dy instrumenteve është të mundësohet një qasje më e mirë deri te financat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Instrumenti i tretë është kredi për rikonstruksion për efikasitet energjetik dhe burime të ripërtërishme të energjisë në sektorin e ndërtesave banesore.

Komisioni inicion dy instrumente të reja:

- *instrumenti për investime të përbashkëta, që mundëson financimin e ndërmarrjeve të sapo hapura si dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.* Shuma e përgjithshme e investimeve që janë kombinim i burimeve publike dhe private mund të jetë deri më 15 milion euro për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

- *fondet për zhvillim urban për përkrahjen e projekteve të qëndrueshme urbane, p.sh në sferën e transportit publik, efikasitetit energjetik dhe revitalizimit të mjediseve urbane.* Projektet duhet të jenë të qëndrueshme financiarisht dhe të jenë pjesë e strategjisë së integruar për zhvillim të qëndrueshëm urban. Shuma e përgjithshme e investimeve që kombinohen nga burimet publike dhe private mund të jetë deri në 20 milion euro për një projekt. Përkrahja do të jetë në formë të fondit për hua të menaxhuara nga ana e ndërmjetësuesve financiar, me mjete nga fondet e ESI dhe kontributit prej së paku 30% të kapitalit privat.

Korniza 2014-2020 të fondeve ESI siguron një fleksibilitet, qartësi dhe mundësi për shfrytëzimin e instrumenteve financiare.

Shtirja e këtyre instrumenteve është zgjeruar në sferat për investim, siç janë përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, efikasitetit dhe efektivitetit energjetik të resurseve, teknologjive digjitale, transportit të qëndrueshëm, hulumtimit dhe zhvillimit të inovacioneve.

Në periudhën 2014-2020 përmes instrumenteve financiare planifikohet që të shfrytëzohen më shumë se 20 miliard euro nga fondet ESI.

http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16

DIREKTIVA PËR SIGURI TË RRJETEVE KOMPJUTERIKE DHE SISTEMEVE INFORMATIVE

Në seancë plenare më 6 korrik të këtij viti Parlamenti Evropian miratoi Direktivën për siguri të rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve informative. Direktiva paraqet një rregull të parë për siguri kompjuterike në nivel të territorit të BE-së. Qëllimi i kësaj Direktive është arritja e një niveli të lartë të përgjithshëm të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve informative në kuadër të BE-së, përmes:

- forcimit të mundësive për siguri kibernetike në nivel nacional,
- bashkëpunimit më të madh në nivel të BE-së, dhe
- obligimet për menaxhim me rrezik dhe informim për shërbimet themelore të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve digjitale.

Çdo vend anëtar duhet të miratoj strategji nacionale për siguri të rrjeteve dhe sistemeve informative për definimin e qëllimeve strategjike dhe politikave adekuate të masave rregulluese. Gjithashtu, do të emërohet një ose më shumë organe nacionale kompetente për përcjelljen e zbatimit të Direktivës në nivel nacional.

Sipas Direktivës së miratuar për siguri të rrjeteve dhe sistemeve informative, do të formohet një grup për përkrahje dhe lehtësim të bashkëpunimit strategjik dhe shkëmbimit të informatave në mes të vendeve anëtare dhe të zhvillohet një besim dhe fshehtësi.

Direktiva krijon një rrjet të ekipeve nacionale për siguri kompjuterike dhe përgjigje ndaj incidenteve (CSIRTs), me qëllim që të kontribuohet për zhvillimin e besimit dhe fshehtësisë në mes të vendeve anëtare dhe të promovohet një bashkëpunim operativ i shpejtë dhe efikas.

Grupi për bashkëpunim do të jetë i përpiluar nga përfaqësuesit e vendeve anëtare, Komisionit dhe ENISA (Agjencisë së BE-së për siguri të rrjeteve dhe informatave). Grupi do të punojë në bazë të programeve për punë në 4 sfera të ndryshme: planifikimin, menaxhimin, shkëmbimin e informatave dhe praktikave më të mira të informimit. Grupi do të

dorëzoj raport për vlerësimin e përvojës së arritur gjatë bashkëpunimit. Raporti do të dorëzohet deri te Komisioni si kontribut për revizion të funksionimit të direktivës.

Operatorët e shërbimeve themelore janë ndërmarrje private ose subjekte publike me rol të rëndësishëm në shoqëri dhe ekonomi. Në pajtim me Direktivën, operatorët e identifikuar të shërbimeve themelore do të duhet patjetër të ndërmarrin masa adekuate për siguri dhe ti informojnë autoritetet nacionale për incidentet e shkaktuara serioze.

Direktiva i përfshinë operatorët e këtyre sektorëve:

- energjetikë: energji elektrike, naftë dhe gaz,
- transport; fluturime, hekurudhë, ujë dhe rrugë,
- sektorin bankar; institucionet kredituese,
- infrastrukturë e tregut financiar: vendet për shitje me pakicë, palë kontraktuese qendrore,
- shëndetësi,
- ujë; oferta dhe distribucion i ujit të pijshëm, dhe
- infrastrukturë digjitale: pikat për qasje të internetit, ofertues sistematik të domentëve, regjistruar të domeneve të nivelit më të lartë.

Komisioni do të miratoj akte për zbatim në drejtim të kërkesave për siguri dhe obligimit për informim, në afat prej një viti, nga dita e miratimit të direktivës. Vendet-anëtare nuk do të kenë mundësi që të imponojnë kërkesa më të ashpra shtesë për sigurinë dhe informimin. Organet kompetente do të mund ti realizojnë aktivitetet e super revizionit vetëm kur janë të bazuara me argumente se ofruesit e shërbimeve digjitale (DSP) nuk i respektojnë obligimet e veta në kuadër të Direktivës.

Pas publikimit të direktivës në Gazetë zyrtare të BE-së, vendet anëtare do të kenë 21 muaj për transponimin e direktivës në legjislaturën nacionale.

<http://europa.eu/rapid/press>



PREZANTIMI I PROGRAMIT DHE PRIORITETEVE TË PUNËS SË KRYESIMIT SLOVAK ME KËSHILLIN E BASHKIMIT EVROPIAN



Komisioni për çështje evropiane pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, më 13 korrik të këtij viti, mbajti një takim të përkushtuar ndaj Prezantimit të Programit dhe prioriteteve të punës së Kryesimit slovak me Këshillin e BE-së për periudhën korrik-dhjetor 2016.

Prioritetet e kryesimit u prezantuan nga ana e ambasadorit të Republikës së Sllovaki në Maqedoni, SH.T Martin Bezak.

Ambasadori Bezak, duke folur për Programin dhe prioritetet në gjashtë muajt e ardhshëm, potencoi se Sllovakia do të fokusohet në *katër segmente*, edhe atë në të parin—Evropë të fuqishme ekonomike, e dyta – Treg unik modern, e treta – Politika të qëndrueshme për migrim dhe azil si dhe e katërta – Evropë e lidhur globale.

Duke folur për temat prioritare, që duhet të jenë në rendet e para të kryesimit Sllovak me BE-në, theksoi se do të udhëhiqen tre parime të lidhura në mes vete, edhe atë: arritja e rezultateve të dukshme, tejkalimi i fragmentacionint (tentim për të arritur rezultate që ndihmojnë në të lidhen vendet anëtare më afër në kuadër të tregut të unifikuar) dhe fokusimit ndaj qytetarëve, me qëllim

që të jepen rezultate konkrete dhe kthimi i besimit te qytetarët në projektin e përbashkët evropian.

Në lidhje me temën, fjalim të tyre kishin: zëvendëskryeministri për çështje evropiane në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë Arbër Ademi dhe zëvendëskryetarja e Komisionit Nora Aliti, të cilët e përshëndetën kryesimin slovak me BE-në dhe i dëshiruan një realizim të suksesshëm të qëllimeve dhe prioriteteve të përcaktuara.

Në debat morën pjesë deputetët: Solza Grçeva, Marija Angelova, Meral Uzeiri Ferati, Trajço Dimkov, Mirvan Xhemali dhe përfaqësuesi i Sindikatës së Republikës së Maqedonisë, Zhivko Mitrevski.

Në seancë ishin të ftuar të marrin pjesë edhe kryetarët, anëtarët dhe përfaqësuesit e Komisionit për politikë të jashtme, Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive, Komiteti i përzier parlamentar i Republikës së Maqedonisë dhe BE-së si dhe Këshilli Nacional për eurointegritim .

www.sobranie.mk

SFIDAT PËR KRIJIMIN E RAPORTEVE TË REJA TË BRITANISË SË MADHE DHE BASHKIMIT EVROPIAN



Pasi që pjesa më e madhe e votuesve në Britani të Madhe më 23 qershor 2016 vendosën që vendi ta lëshojë Bashkimin Evropian, çdokush pyetet se çka pason më tutje.

Bashkimi Evropian dhe Britania e Madhe duhet të hapin negociatave për kushtet e marrëdhënieve të reja ndërkombëtare. Parlamenti Evropian do të ketë rol kyç në vendimin për rezultatet e negociatave.

E drejta e vendeve anëtarë për tërheqje nga Bashkimi Evropian është e paraparë në nenin 50 të Marrëveshjes së

Lisbonës, në të cilën theksohet se BE dhe vendi që tërhiqet duhet të hapin marrëdhënie për marrëdhëniet e ardhshme.

Për çfarëdo marrëveshje në mes të palëve, Parlamenti Evropian dhe Këshilli duhet të japin dritë të gjelbër. Këshilli duhet të votojë pro me së paku 72% të anëtarëve që së bashku paraqesin 65% të popullsisë së BE-së .

<http://www.europarl.europa.eu/news>

PROPOZIM-BUXHETI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR VITIN 2017

Komisioni Evropian më 30 qershor të këtij viti e prezantoi propozim-buxhetin e BE-së për vitin 2017 që është 134,9 miliard euro, i fokusuar në dy prioritete kryesore të politikës evropiane: përkrahjen e përmirësimit vijues të ekonomisë evropiane dhe zgjidhjes së problemeve të sigurisë dhe atyre humanitare në fqinjësi.

Më tepër mjete do të dedikohen për investime në rritjen, punësimin dhe konkurrencën e BE-së si dhe sigurimit të mjeteve të nevojshme për mbrojtjen e kufijve të jashtëm të BE-së, përmirësimin e sigurisë së unionit edhe jashtë sajë, për përkrahjen dhe pranimin e integritetit të refugjatëve dhe zgjidhjen e arsyeve kryesore për migrim në vendet amë dhe vendet e tranzicionit.

Mjetet e dedikuara për përkrahjen e rritjes ekonomike në vitin 2017, janë në shumë prej 74,6 miliardë, në krahasim me 69,8 miliard euro në vitin 2016, dhe të njëjtat do të distribuohen:

- 21, 1 miliard euro për rritjen, punësimin dhe konkurrencën; përfshinë edhe 10,6 miliard euro për hulumtime dhe shpikje në kuadër të HORIZON 2020, 2 miliard për arsimimin për programin Erasmus+, 299 milion euro për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në kuadër të programit COSME dhe 2,5 miliardë në kuadër të Instrumentit për lidhjen e Evropës (CEF),

- 2, 66 miliard janë të dedikuara për Fondin evropian për investime strategjike (EFSI) në kontekst të planit Evropian për investime, dhe

- 53,57 miliard euro për përkrahjen e investimeve produktive dhe reformave strukturore, me qëllim që të nxitet heqja e dallimeve në mes vendeve anëtare dhe rajoneve me ndihmë të fondeve strukturore dhe investuese të BE-së (ESIF).

Në Propozim-buxhetin për vitin 2017 është paraparë shumë prej 5,2 miliard euro për forcimin e kufijve të jashtëm të Unionit si dhe për zgjidhjen e krizës së refugjatëve dhe migrimit ilegal me financimin e mjeteve më të forta për pengimin e tregtisë me njerëz dhe adresimin e faktorëve afatgjatë për migrim në bashkëpunim me vendet amë dhe

vendet tranzituse, politika të forta në sferën e migrimit legal si dhe mjete për përkrahjen e vendeve anëtarë në aspekt të integritetit të refugjatëve në BE.

Për shkak të problemeve të rritura të sigurisë në BE dhe në vendet e saja anëtare, me propozim-buxhetin e BE-së për vitin 2017 mjete të konsiderueshme janë të dedikuara edhe në këtë drejtim.

Shuma prej 111.7 milion euro do të dedikohen për përkrahjen e Europolit, 618 milion euro do të dedikohen për forcimin e sigurisë së institucioneve të BE-së, me 16 milion euro shtesë, të dedikuara për masat e sigurisë në vitin 2016.

Për çdo program të financuar me propozim-buxhetin e BE-së për vitin 2017 janë të futura dy shuma: obligime dhe pagesa. "Obligime" janë mjetet e vitit të dhënë të cilat në bazë të marrëveshjes mund të dedikohen për financimin, dhe "pagesën" e shumës që në fakt është e paguar. Në Propozim-buxhetin për vitin 2017 obligimet janë në shumë prej 157,7 miliard euro (në krahasim me 155,0 miliard euro gjatë vitit 2016), pagesat janë 134,9 miliard euro (të zvogëluara prej në 143,9 miliard euro në vitin 2016). Dallimi sqarohet me inkorporimin e ngadalshëm të programeve kohezive në periudhën 2014-2020. Shuma e plotë prej 134,9 miliard euro ka të bëjë me pagesat, përderisa të gjitha shumatat e tjera të theksuara më lartë kanë të bëjnë me obligimet e propozuara.

Buxheti i BE-së është rreth 1% të BPV në BE, por falë efektit të dyfishimit dhe me udhëzimet drejt rezultateve, ndikimi i tyre është i shkëlqyeshëm. P.sh në periudhën 2007 deri në 2013, rritja mesatare e BPV si rezultat i politikës së kohezionit vlerësohet në 2,1% në nivel vjetor në Letonisë, 1,8% në nivel vjetor të Lituanisë dhe 1,7% në nivel vjetor në Poloni .

<http://europa.eu/rapid/press-release>



VJENA – KRYEQENDRA EVROPIANE E AKULLORES



Austria është qendra e Evropës kur bëhet fjalë për akulloren, shikuar nga ana e popullsisë dhe me hapësirë më të madhe për shitjen e këtij deserti të ngrirë.

Sipas informatave të Odës ekonomike të Austrisë, në këtë vend evropian në cdo 15.000 banorë ekziston një vend për akullore. Austria e tejkalon Italinë që është vend me një traditë shumë më të gjatë për akullore.

Austria, e veçanërisht qyteti i Vjenës në vitet e fundit shënon një rritje të konsiderueshme të numrit të vendeve ku shitet akullorja. Sot në Vjenë punojnë 154 objekte për akullore me përjashtim të kafeneve dhe ëmbëltoreve që në ofertat e tyre gjithashtu kanë edhe akullore.

Interesimi serioz për akullore në Austri daton nga mesi i shekullit 19, kur në këtë vend kanë imigruar prodhues italian të

akullores duke marrë me vete edhe recetat e këtij produkti të shijshëm. Në këtë kohë, e njohur tani më për kekët e saja luksoz, Austria ka futur në ofertat e veta edhe akulloren me një kualitet të mirë.

Sot, qytetarët e Vjenës e duan aq shumë akulloren sa që edhe janë nikoqir të një festivali kushtuar akullore që mbahet çdo verë në parkun e qytetit Burgarten.

Këtë vit, festival të akullores në Vjenë do të mbahet më 6 dhe 7 gusht .

<http://www.thelocal.at/20160613>

LIGJ I RI PËR SHITJEN E PRODHIMEVE VENDASE NË RUMUNI



Presidenti rumun Klaus Johanis më 11 korrik të këtij viti nënshkroi një ligj me të cilin shitoret e vendit obligohen që së paku 51% të shitjes së prodhimeve (mish, pemë, vezë dhe perime) ta kenë nga prodhimi vendas. Ligji u miratua nga ana e parlamentit në qershor me qëllim të përkrahjes së bujqve vendas.

Kjo masë do të vlejë vetëm për ushqimin, te tregtarët që kanë qarkullim vjetor më të madh se dy milion euro. Për shitoret që do ta shkelin ligjin, dënimi është prej 100.000 deri në 150.000 lei (24.600 deri në 36.800 dollarë), por në rast se më shumë herë shkelet ligji, do të mund edhe të mbyllen.

Ligji hasi në kritika nga ana e Shoqatës së kompanive të mëdha të shitjes me pakicë, që vlerëson se do të sjellë deri te një rritje e çmimeve të mallrave, duke lënë mijëra furnizues pa punë.

Deri më tani nuk dihet nëse ligji është në pajtim me rregullat për mbrojtjen e

konkurrencës dhe i njëjti mund të kontestohet në Gjykatën Kushtetuese.

Qeveria e Polonisë më 14 qershor të këtij viti miratoi propozim-ligjin që parasheh futjen e një tatimi të ri për tregtinë me pakicë, a.sh “tatimi i supermarketeve” Tatimi do të duhej që të paguhet nga ana e kompanive që gjenerojnë të hyra më shumë se 17 milion zloti ose 3,8 milion euro, kurse shkalla tatimore do të rritet sipas të hyrave të realizuara. Qeveria konsideron se është koha që tregtarët e vogël polak të sigurojnë mundësi të barabarta për tu matur me zinxhirët e madhej tregtarë nga jashtë, të cilët nga ana tjetër e konsiderojnë këtë hap si “diskriminues dhe ksenofobik” .

<http://www.romania-insider.com/new>

HETIM I INICIUAR PËR DAMPING ÇMIMET E ÇELIKUT

Komisioni Evropian filloi një hetim kundër një numri të madh të vendeve, përfshirë edhe Serbinë, për shkak të damping çmimeve të çelikut. Hetimi duhet të zgjasë disa muaj, kurse pas përfundimit të tij, Komisioni do të përcaktojë nëse do të marrë masa anti-damping. Më 10 korrik të këtij viti qeveria Serbe, qartë bëri medije se do të bashkëpunojë me Komisionin Evropian në lidhje me këtë hetim.

Komisioni Evropian më 8 korrik publikoi se fillon hetime nëse ekziston damping gjatë importit të çelikut të përpunuar, në tregun e BE-së nga Brazili, Irani, Rusia, Serbia dhe Ukraina. Në deklaratë është theksuar se këto prodhime shfrytëzohen në prodhimin e produkteve tjera nga çeliku ose drejtpërdrejt në industri, përfshirë edhe ndërtimtarinë dhe ndërtimin e anijeve. Hetimi ka të bëjë me periudhën nga 1 korriku 2015 e deri më 30 qershor 2016.

Komisioni në afat prej 9 muajve duhet të konstatojë nëse janë plotësuar kushtet për futjen e të dhënave kompensuese edhe për 6 muaj shtesë të vendos nëse do të shqiptohet masë përfundimtare.

Hetimi është iniciuar në bazë të ankesës së Bashkësisë Evropiane të prodhuesve të çelikut EUROFER të parashtruar më 23 maj të këtij viti në bazë të nenit 5 të rregullave

për mbrojtjen nga damping importi nga vendet që nuk janë anëtare të Bashkësisë Evropiane.

Në rastin me Serbinë, prodhuesit evropian të çelikut thirren në Protokollin 5 nga Marrëveshja për stabilizim dhe asocim, që ka të bëjë me ndihmën shtetërore dhe procedurave eksportuese. Hetimi është i iniciuar në një moment të ndijshëm për Serbinë, kur prej më pak se dy javë kompania kineze Hest e mori hekurin në Smederevë.

Komisioni përkujtoi se në shkurt dhe maj të këtij viti janë iniciuar hetime për damping dhe subvencione për prodhime të ngjashme, të importuara nga Kina, si dhe ajo se në BE vetëm se po zbatohen 37 masa për shkak të dampingut dhe subvencionimit të prodhimtarisë.

Komisioni Evropian theksoi se anti-damping hetimi është i rregulluar me procedura më të ashpra në pajtim me rregullat e BE-së dhe Organizatës botërore tregtare dhe se të gjitha palët e interesuara mund të parashtrojnë padi dhe të marrin pjesë në ato debate .

<http://webtribune.rs/>



ЕУ КАЛЕНДАР / септември 2016

1. Seanca plenare e parlamentit të Evropës, 12-15/09/2016 Strasburg 2

. Samiti i parë i biznesit të ekonomisë së zezë si dhe forum shkencor, 12-13/09/2016, Hamburg, Gjermani

3. Horizont 2020 Ditë informuese "aksioni klimatik, ambienti jetësor, efikasiteti i resurseve dhe lëndëve të para",


14/09/2016, Bruksel, Belgjikë,

4. Këshilli i punëve të përgjithshme, 20/09/2016, Bruksel, Belgjikë

5. Marko-java rajonale inovative, 26-30/09/2016, Trst, Itali 4. Këshilli i punëve të përgjithshme, 20/09/2016, Bruksel, Belgjikë

5. Marko-java rajonale inovative, 26-30/09/2016, Trst, Itali,

5. Марко-регионална иновативна недела, 26-30/09/2016, Трст, Италија.



European Union
Newsroom

europa.eu

EUROPA > Newsroom > Calendar

Home
Highlights >
Press releases >
Calendar >
Audiovisual
Press contacts
Press facilities >
About the EU >

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic

By organiser

By type

BY MONTH

September

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
					1	2
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	



KUVENDI I REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori бр. 10, Shkup, 1000

Telefoni: +389 2 3 11 22 33 lokali 414 dhe 289

faksi: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyre 019

**Sektori per perkrahen e Keshillit nacional
per eurointegrime**

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011 - qershor 2012 u realizua IPA projekti për "Ndihmë teknike të Parlamentit", qëllimi i së cilës ishte forcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit edhe atë duke përmirësuar transparencën dhe përgjegjësinë para qytetarëve.

Në kuadër të IPA projektit, u siguroa ndihmë financiare dhe profesionale për vendosjen e qendrës së BE -së në Kuvend.

Qëllimi i formimit të BE qendrës ishte që deputetëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe shërbimit të Kuvendit tu sigurohet një qasje më e mirë deri te informatat në lidhje me çështjet e BE-së.